**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 599/19
Datë/Datum 08.10.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

---

**PSH .nr. 519 /19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenković - Kryetar, z . Nuhi Paçarizi- Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatoreve ekonomik: "El-Bau" sh.p.k &N.N.T ''Eing Com''&Ve-Mor''sh.p.k - Gjilan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: "Arbor Group'' shpk - Kamenicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ''Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave gjelbëruese", me nr. prokurimi: 651-18-4706-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal – Gjilan, më datën: 23.09.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**I.APROVOHET,** si e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik: "El-Bau" sh.p.k &N.N.T ''Eing Com''&Ve-Mor''sh.p.k - Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ''Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave gjelbëruese", me nr. prokurimi: 651-18-4706-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal – Gjilan.

**II.ANULOHET,** njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ''Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave gjelbëruese", me nr. prokurimi: 651-18-4706-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal – Gjilan, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

**III**. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e grupit të operatorëve ekonomik: "El-Bau" sh.p.k &N.N.T ''Eing Com''&Ve-Mor''sh.p.k - Gjilan, aprovohet si e bazua, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

**VI** .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 02.07.2018.
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 23.07.2018.
Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 23.07.2018.
Data e përfundimit të ri vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 26.07.2019.
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të pa suksesshëm është bërë me dt: 26.07.2019.
Data e njoftimit mbi Vendimin e AK-së B58 është bërë me dt: 26.07.2019.
Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 29.07.2019.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 08.08.2019.

Grupit i operatorëve ekonomik: "El-Bau" sh.p.k &N.N.T ''Eing Com''&Ve-Mor''sh.p.k - Gjilan, si palë te pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 16.08.2019 me nr. 519/ 19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ''Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave gjelbëruese", me nr. prokurimi: 651-18-4706-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal- Gjilan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 paragrafi 1 dhe 2, neni 6 paragrafi 1, neni 7 paragrafi 1,2,4, neni 52, neni 56 paragrafi 1.1 dhe 1.2, neni 59 paragrafi 4 ,neni 60 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, neni 69 paragrafi 4.4 , neni 71 paragrafi 4, nenin 108/A nenin 8.2 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin

4.4, nenin 41.11, nenin 26, nenin 41.3, dhe 41.7, të RrUOOPP-së. Vendimit të OSHP-së, PSH.nr. 52/19, të dt: 02.04.2019, si dhe Urdhëresën e dt: 26.07.2019.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 26.08.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 30.08.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimet OE ankues Nr. 1

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 1, 6, 7, 52, 56, 59, 69, 71, 72, të LPP-së, si dhe Vendimin e OSHP-së Nr. 52/19 të datës 02.04.2019, Urdhëresë Nr. 52/19 me datë 26.07.2019.

Eksperti shqyrtues sqaron, se bazuar në Rregulloren Nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16 (Rastet e unifikuara) par. 2) dhe 3), janë përsëritur, pretendimet ankimore te njëjta për palët ne procedurë lidhur me këto pretendime ankimor, ku objekt i kontestit dhe palët janë te njëjta, për rastet te cilat janë shqyrtuar me parë, si çështje te gjykuara "resjudikata", sipas nenit 105.2.16 te LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit (ne këtë aktivitet te prokurimit),sqaron se AK - komisioni i Ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar, drejt ofertën e OE ankues pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit si dhe nuk ka respektuar Vendimin e OSHP-së, Nr. 52/19 të datës 02.04.2019, Urdhëresë Nr. 52/19 me datë 26.07.2019, duke mos vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së. Prandaj, në bazë të analizës se mësipërme sqarojë se pretendimet e palës ne ankese janë të qëndrueshme.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara qe te sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marr ne konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet ne nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikas, me transparent dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve dhe burimeve publike, duke vepruar

ne pajtim me dispozitat ligjore te LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Eksperti shqyrtues profesional, duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezantuara në dosjen e tenderit, raport, si dhe rrjedhën nga ana e AK-së, në ankesa e OE: "EL-BAU" Sh.p.k. & N.N.T."Eing Com" & "VE-MOR" Sh.p.k. - Gjilan, për tenderin e AK: Kuvendi Komunal – Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave gjelbëruese", me nr. prokurimi: 651-18-4706-2-2-1, lidhur me njoftimin për kontratë, rekomandon që ankesa e OE ankues të aprovohet si të bazuara, (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet si më lartë) dhe të njëjtin tender rekomandojmë autoritetin kontraktues/Panelin Shqyrtues, që ky aktivitet i prokurimit të Ri-vlerësohet dhe të veproj në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të LPP-së.

Operatori ekonomik, përmes parashtresës me shkrim të datës: 02.09.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues, përmes parashtresës me shkrim të datës: 11.09.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23.09.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i AK, përfaqësuesi i OE-së ankuese, eksperti profesional i prokurimit, ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Pireva deklaroj: Të nderuar Panel Shqyrtues, AK- Komuna e Gjilanit, gjatë rivlerësimit të ofertave të OE ankues "El-Bau" dhe OE "Arbnor Group" , nuk e ka respektuar vendimin OSHP-së, PSH.nr.52/19, të dt. 02.04.2019, dhe Urdhëresa PSH.nr.52.19 të dt. 26.07.2019. Rezultati i ri-vlerësimit për eliminimin e OE ankues "El-Bau", me arsyen e njëjtë dhe dhënia e kontratës OE "Arbnor Group" është bazuar në ÇËSHTJEN E GJYKUAR "RES JURIDICATA" me vendimin PSH.nr.52/19 i dt. 02.04.2019. Me të njëjtin vendim paneli në mënyrë meritore kishte vendosur se: është e paqëndrueshme arsyeja e eliminimit të OE ankues të dhënë nga ana e AK-së.... se ekzaminimi, krahasimi dhe vlerësimi i ofertave nuk është bërë në pajtim me nenin 59.4 të LPP-së dhe nuk është respektuar neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënien e kontratës- që ka qenë

tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët ngase është shpallur fitues OE Arbnor Group), i cili ka ofertë më të shtrenjtë me një dallim prej 18.159.62 €, se sa oferta e OE ankues ''El-Bau''.

Ndërsa AK edhe pse e ka pasur obligim ligjor për ta kryer ri-vlerësimin në bazë të udhëzimeve të vendimit të OSHP-së, PSH.nr. 52/19, dhe Urdhëresën e nxjerrë me dt. 26 korrik 2019, nuk e ka përfillur dhe zbatuar fare vendimin e OSHP-së, PSH.nr.52/19, por edhe për herën e tretë e ka lënë rezultatin e njëjtë me arsyen e njëjtë për eliminimin e OE ankues duke e orientuar dhënien e kontratës OE "Arbnor Group" përkundrejt faktit se objekti i kontestit (pretendimet e njëjta) dhe palët ishin të njëjta dhe kjo çështje ishte zgjidhur përmes vendimit PSH.nr.52/19, e që në bazë të nenit 105 par.2.16 të LPP-së, konsiderohet çështje e gjykuar "RES JURIDICATA".

Dhënia e kontratës OE "Arbnor Group" është bërë në kundërshtim me kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin e dhënies së kontratës të specifikuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, dhe në kundërshtim me nenin 56 par.1.1 dhe 1.2, nenin 59.4, nenin 60 par.1.1. lidhur me dispozitat nga neni 65-70, të LPP-së.

OE "Arbnor Group" nuk e ka plotësuar kërkesën e specifikuar në nr. 2 të nenit 9.1&9.2 të FTD-së, lidhur me aftësitë profesionale përkatësisht stafin profesional një ing ose bach i komunikacionit dhe një ing ose bach i bujqësisë. Po ashtu nuk e ka plotësuar kërkesën e specifikuar pikën Evidenca 3 të nenit 9.2 të FTD-së lidhur me aftësitë teknike përkatësisht pajisjet e ofruara që i ka në pronësi apo posedim për realizimin e këtij projekti të kërkuara në nenin 9.1 lidhur pajisjet e kërkuara si në me pikat: 3, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 12 të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Meqenëse ky pretendim nuk është shqyrtuar nga eksperti shqyrtues, kërkojmë që këto fakte të shqyrtohet dhe merret parasysh nga ana e panelit shqyrtues. Ne konsiderojmë se AK në mënyrë të qëllimshme nuk po ndërmerr veprime korrigjuese të cilat i keni rekomanduar me vendimin PSH.nr.52/19, dhe në anën tjetër po nxjerr vendim favorizues për dhënien e kontratës OE që nuk i plotëson kriteret e përzgjedhjes dhe as kriterin e dhënies së kontratës. Prandaj duke pasur parasysh se kjo lëndë ka kaluar tri herë në ri-vlerësim dhe AK fare nuk po i zbaton vendimet e OSHP gjatë rivlerësimit mirëpo po e përsërit vazhdimisht rezultatin e njëjtë ne konsiderojmë se nuk ka asnjë bazë ligjore që të veprohet ndryshe.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Bajrami deklaroj: Ne si AK, nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit dhe mbetemi prapa vendimit tone, pasi qe Autoriteti Kontraktues komisioni i vlerësimit gjatë vlerësimit te ofertave ka ber ekzaminimin dhe vlerësimin e tyre dhe ka konstatuar se OE ankues marrëveshjet i ka te lidhura me nj e kompani qe nuk ka marrëveshje për konsorcium po ashtu

komisioni gjatë vlerësimit ka hasur se cisterna e pompës se ujit nuk i plotëson kushtet dhe kriteret qe kërkohen ne DT andaj komisioni ka shpallur te papërgjegjshëm këtë OE dhe ne mbetemi prapa vendimit te Autoritetit Kontraktues dhe te hudhet ankesa si e pa bazuar.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti profesional i prokurimit z. Beqiri deklaroj: Mbetem prapa ekspertizës, ne bazë te neneve kanë qenë te njëjta mirëpo ne deklarate janë ndërruar dhe kam dhënë qe te kthehet ne rivlerësim, sa i përket Autoriteti Kontraktues nuk është cekur cisterna dhe nuk qendrën. Mbetem pran ekspertizës.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Pireva deklaroj: Kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që mos të kërkojë as rivlerësim por lëndën ta vendosë vet ku në njërën nga pikat e dispozitivit të këtij vendimi ta VËRTETOJE, njoftimin për dhënien e kontratës i datës 28.09.2018, operatorit ekonomik "EL-BAU" sh.p.k. &N.N.T. "Eing com" & "VE-MOR" sh.p.k., Gjilan.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z.Bajrami deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te refuzohet ankesa e OE si e pa bazuar dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron pretendimet e OE ankues se autoriteti kontraktues KK-Gjilan, nuk ka respektuar nenet 1, 6, 7, 52, 56, 59, 69, 71, 72, të LPP-së, si dhe Vendimin e OSHP-së Nr. 52/19, të datës 02.04.2019, si dhe Urdhëresë me Nr. 52/19, të datës: 26.07.2019.

Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se bazuar në Rregulloren Nr. 01/2017, të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16 (Rastet e unifikuara) par. 2) dhe 3), janë përsëritur, pretendimet ankimore te njëjta për palët ne procedurë lidhur me këto pretendime ankimor, ku objekt i kontestit dhe palët janë te njëjta, për rastet te cilat janë shqyrtuar me parë, si çështje te gjykuara "resjudikata", sipas nenit 105.2.16 te LPP-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se pretendimet e OE ankues janë të bazuara për faktin se autoriteti kontraktues KK-Gjilan, gjegjësisht komisioni i Ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar, drejt ofertën e OE ankues pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit

si dhe nuk ka respektuar Vendimin e OSHP-së, me Nr. 52/19 të datës 02.04.2019, si dhe Urdhëresë Nr. 52/19, të datës: 26.07.2019, duke mos vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së. Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së, dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesues i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK- Kuvendi Komunal – Gjilan

1x1 OE- "El-Bau" sh.p.k &N.N.T ''Eing Com''&Ve-Mor''sh.p.k - Gjilan.

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.